



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE  
SEKTORI I PROKURIMEVE**

**Durrës, më 13.05.2024**

**PROCESVERBAL  
Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë 13.05.2024 në Durrës, nga ana e njësisë së prokurimit, ngritur me urdhrin nr. 3326/2 prot., datë 30.04.2024, me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘E Hapur’, me të dhënat si më poshtë vijon:

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV: - Instalime të pajisjeve të ndriçimit rrugor 45316110-9.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 24.859.914 (njëzet e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) Lek neto pa TVSH.

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS  
LIMIT TË KONTRATËS**

**Argumentim:**

Në zbatim të urdhërit të grupit të Specifikimeve nr.77, datë 11.03.2024, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të bashkisë të vitit 2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentet lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës në Bashkinë Durrës.

## **PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktura, objekt i këtij prokurimi.

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.*

## **1. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS**

**Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit:**

“Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

Grupi i punës u bazua në projektin dhe preventivin e paraqitur nga njësia e projektit dhe infrastrukturës për projekt zbatimin e objektit, konkretisht në V.K.M-në nr.216, datë.13.04.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Afati i realizimit të punimeve është 56 dite, sipas grafikut të punimeve.

Garancia për mbulimin e difekteve që mund të lindin gjatë shfrytëzimit të objektit, nga ana e firmës të jetë 2 vjet.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe perllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së i ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme ( sipas shtojcës 7)

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe nenit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 24'000'000 lekë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas

Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2024 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 12’000’000 Lekë, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 48’000’000 lekë.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- i. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, *të shoqëruara me formular vlerësimi sipas shtojcës 9.*
- ii. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 39 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

---

**Aftësitë teknike dhe profesionale te tjerat si me poshtë janë hartuar, vendosur dhe perlllogaritur nga struktura të posacme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punes për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”:**

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1A** Punime gërmimi në tokë
- **NP-4A** Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- **NP-11A** Ndertim per n/stacion kabina e transformatore, linja të tn, të mesëm dhe shpërndarja e energjisë
- **NS-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **NS-14A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- **N.S. 18-A-** Punime topogjeodezike;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” indryshuar si dhe Vendimit nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

### Kategoritë e poshtëshënuara, janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve,

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
<b>NP-1 A</b>	Punime germimi ne toke	<i>Emërtimi i Punimeve</i> Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.	<b>A.</b> 0-20 milionë lekë 3,664,284 Tot.
<b>NP-4 A</b>	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Konsiderohen Punime sipas zerave te preventivit , Asfaltimet ,betonimet Shpim me sonda "UKS" Ø 1m, ~ 20m,toke zhavore. Kalimi i shinave te trenit	<b>A.</b> 0-20 milionë lekë 3,148,203 Tot.
<b>NP-11-A</b>	Ndërtime për N/stac., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë .	Konsiderohen Punime sipas zerave te preventivit nr F.V F.V shtylle ndricimi me shkalle mbrojtje IP65 dhe instalimi i poleve të ndriçimit në natyrë shumëdimensionale me profilet e çelikut te galvanizuar CORTEN - lartësia 7.0 m - pajisur me nje kuti trefazore te inspektueshme - - fenere dhe difuzorë prej metakrilati te tejdukshem te kompletuar me me 3 ndricues LED (prozhektore) me 31 w secila njesi kompletuar me prozhektorë dhe llampa. Tipi 2 FV. Shtylle ndricimi dekorative Cilindrike H = 9.8 m me dy diametra D1 130 dhe D2 90 e zinguar dhe e lyster me boje elektrostastatike me pjekje ne temp 400°C e kompletuar me morsete, kapak, sigures me spesor 2.5 - 3.5 mm. Shoqcruar me dy ndricues dekorativ LED OSRAM ku duhet te jete jo me i vogel se 21000 Im, me ngjyre drite 4000K me lente polikarbonat asimetrike dhe guarnicion sillkonl. Ndricueset duhet te jene me krah dekorativ. Karkasa c ndricuesve duhet te jete alumln jonidizuar dhe i lyster me te njejten ngjyre te shtylles. Tipi 3 FV. Shtylle ndricimi dekorative Cilindrike H = 7.8 m me dy diametra D1 114 dhe D2 76 e zinguar dhe e lyster me boje elektrostastatike me pjekje ne temp 400°C e kompletuar me morsete, kapak, sigures me spesor 2.5 - 3.5 mm. Shoqcruar me nje ndricues dekorativ LED OSRAM ku duhet te jete jo me i vogel se 21000 Im, me ngjyre drite 4000K me lente polikarbonat asimetrike dhe guarnicion sillkoni. Ndricuesi duhet pa krah dhe i futur ne shtyll . Karkasa e ndricuesit duhet te jete alumln jonidizuar dhe i lyster me te njejten ngjyre te shtylles. Tipi 4	<b>A.</b> 0-20 milionë lekë  Tot. <b>12,070,574</b>  lekë

		FV. Shtylle ndricimi dekorative Cilindrike H = 9.8 m me dy diametra D1 130 dhe D2 90 e zinguar dhe e Iyer me boje elektrostastatike me pjekje ne temp 400°C e kompletuar me morsete, kapak, sigures me spesor 2.5 - 3.5 mm. Shoqcruar me nje ndricues dekorativ LED OSRAM ku duhet te jete jo me i vogel se 21000 Im, me ngjyre drite 4000K me lente polikarbonat asimetrike dhe guarnicion sillkonl. Ndricuesi duhet te jene me krah dekorativ. Karkasa e ndricuesve duhet te jete alumln jonidizuar dhe i lyer me te njejten ngjyre te shtylles. Tipi 5	
<b>NS-1 A</b>	Punime për prishjen e ndërtimeve	Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja e infrastruktures tokesore dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.	<b>A. 0-20 milionë lekë</b> Tot. <b>717,311.38</b> lekë
<b>NS-14 A</b>	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	<i>Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë rrealizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.</i> Konsiderohen Punime sipas zerave te preventivit nr Kabull cu FROR 5X6mm2 , tokezim me neuter te perseritur . F.V.Kabell cu FROR 3 x 4mm2. F>V Kabull cu FROR 3x2.5mm2., F.V Shirita sinjalizimi per kabull nen toke me gjith gjatesine e linjes se ndricimit , F.V Elektroda tokezimi , profil zingato e bakterizuar L=1.5 , FV, Shtyll cilindrike h= 3.5 ml ,D=130mm i zinguar ne te nxehte dhe e lyer me boje elektrostatike me shkalle mbrojtjeje IP 68 . Ndricuesi 30watt polikarbonat transparent.Ngjyra e drites 4000-5000K. TIPI 1 F.V Kabull cu FROR 5X6mm2 , tokezim me neuter te perseritur . F>V Kabull cu FROR 3x2.5mm2., F.V Shirita sinjalizimi per kabull nen toke me gjith gjatesine e linjes se ndricimit , F.V Elektroda tokezimi , profil zingato e bakterizuar L=1.5 , F.V shtylla	<b>A. 0-20 milionë lekë</b> Tot. 4,858,916 lekë
<b>NS-18 A</b>	Punime topogjeodezike	Punime topografike sipas natyres se objektit	<b>Vlera e parashikuar ne preventiv</b>

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

a. Inxhinier Elektrik 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të paraqese dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*



**2.3.4** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **staffin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- b. Inxhinier Gjeodet 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale (diploma e inxhinierëve, teknikut të ndërtimit) ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. Teknik Ndërtimi 3 (tre)
- b. Elektricitist 15 (pesëmbëdhjetë)
- c. Teknik Elektroteknik 2 (dy)
- d. Manovradorë 1 (një)
- e. Drejtues Mjeti 3 (tre)
- f. Punëtor të thjeshtë 15 (pesëmbëdhjetë)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune. Ndërsa për punëtorë të thjeshtë ndërtimi, të disponojë një vetëdeklarim nga shoqëria, ku listohen si punëtorë të thjeshtë ndërtimi. Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- **Inxhinieri Elektrik** është i nevojshëm për inspektimin e punimeve elektrike, në të cilën do bëhet shtrimi i linjave dhe lidhja e tyre, lidhja e ndricuesve dhe kuadrot e komandimit.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është i nevojshëm për punimet e ndërtimit do të jete përgjegjës për kontrollin e cilesise të gjithë betonit, për punën që përfshin ky seksion specifikimesh.

- **Inxhinier Gjeodet** është përgjegjës për azhornimin dhe piketimin e objektit.
- **3 (tre) Teknik ndertimi:** Tekniku i Ndërtimit ndjek nga afër ecurinë e vazhdueshme të punës në objekt gjatë të gjitha fazave si: gërmimi, betonimi etj. Tekniku lexon dhe kontrollon zbatimin e proejktit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe informon inxhinierin për ecurinë e punës në kantier, duke koordinuar punen ne fronte të ndryshme.
- **15 (Pesembedhjet) punonjes Elektracist:** Elektracistët janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi zërat e preventivit përmbajnë pjesën më të madhe punime elektrike.
- **2 (Dy) Teknik Elektroteknik:** Teknik Elektroteknik janë të nevojshëm për zbatimin e kontratës si dhe për rrymat e dobëta dhe panelet elektrike.
- Manovratorët janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve të rënda.
- **3 (tre) Drejtues mjeti:** Drejtuesit e mjetit janë të nevojshëm për drejtimin e mjeteve si vinç, kamion, kamioncinë, Automjete për platforma per punime ne lartesi etj.
- **1 (një)Manovratori:** është i nevojshëm për drejtimin e mjetit si minifadrom.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoare prej **minimalisht 42 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri prej 42 punonjës përfshin 15 punëtorë të thjeshtë + 27 personat që janë stafi i kualifikuar i inxhinierëve dhe teknikëve, drejtues mjeti, manovratorë të përmendur më lart. Ky numër është llogaritur analitikisht në grafikun e punimeve duke përdorur orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv për kohën kur shënohet piku i punimeve gjithashtu per llogaritjen e numrit te punonjesve janë marre parasysh kombinimet e mundshme të punonjësve të specializuar dhe atyre të thjeshtë.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

1	Mjet për punime në lartësi (mjet me kosh per ndricuesit )	copë 2
3	Minifadrome	copë 1
4	Mjet per punime me sond (Autosond)	copë 1
5	Motogjenerator/gjenerator	copë 1
6	Kamion me kapacitet mbajtes 3.5 min deri ne 7.5 ton maksimum.	copë 1
7	Kamion me masë maksimale te autorizuar 7.5– max 18 ton	copë 2

9	GPS	copë 1
10	Freze asfalti (sharre per prerje asfalti)	copë 1
11	Betoniere kantieri	copë 1

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituar të disponojë: Dëshmi, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës të shoqëruar me dokumentat si: Leja e qarkullimit, Certifikata e Kontrollit Teknik, Certifikata e transportit të malrrave/Liçencë, Foto e mjetit (Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të disponojë dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj). Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes se Formularit përmbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumetimi:** Mjetet e mësipërme kërkohen: duke u bazuar në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit të kryera gjatë periudhës më të ngarkuar (pikut) duke marrë parasysh edhe kombinimet e mundshme të punëve në kantier si dhe mjetet dhe pajisjet e kërkuara nga projektuesit.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas Vendimit nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe Udhëzimit nr.2, datë 08.05.2003, ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Referuar VKM nr.629, datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve / makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

### 2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata:

- a. Certifikat: ISO 9001 -Sistemi i Menaxhimit të cilesisë, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

- b. Certifikat: ISO 45001 : 2018 - Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Sistemi i manaxhimit te sigurise dhe shendetit ne vendet e punes mundeson qe çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

### **Kriteret për shpalljen e ofertës fituese**

Bazuar në pikën 3, neni 45 Seksioni III VKM 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK “Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet **në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave**”.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose*

*shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhënat e mëposhteme:

## **1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor**

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)  
Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

**2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur, Punë.

**3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-04448-05-13-2024

**4. Objekti i kontratës /Marrëveshjes Kuadër:** “Rehabilitim i ndriçimit të akseve rrugore në qytetin e Durrësit”.

**5. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):** Emërtimi dhe identifikimi i Kodi CPV: - Instalime të pajisjeve të ndriçimit rrugor 45316110-9.

**6. Fondi limit:** 24.859.914 (njëzet e katër milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e katërbëdhjetë) Lek neto pa TVSH.

**7. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 56 (pesëdhjetë e gjashtë) ditë.

**8. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** **29.05.2024, ora 10.00.**

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njesisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarëve të njesisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

### **Njësia e Prokurimit**